



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2023:278422

Datë: 17.07.2024

Numri i dokumentit: 05947216

K.DH.SH.II.nr.1128/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Global Ing SHPK me NUI 811870931 seli ne Podujeve, ndaj debitorit Trepça Sha me seli ne Mitrovicë, bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.21412/23 të datës 30.04.2024, me datën 17.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit Trepça Sha me seli ne Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, KPPP.nr.2141/23 të datës 30.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se pare-Departamenti Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.160/2023, të datës 29.11.2023, të Përmbartuesit Privat. Mbetë ne fuqi Urdhri përmbartimor P.nr.160/2023, të datës 29.11.2023.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbartimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe shkeljes se te drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar te anuloj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të

Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbaremore ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturave me nr. 18/23 dt.18.04.2023 dhe 29/2023 dt.05.07.2023. Përmbaremoresi privat, sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbaremore P.nr.160/2023, të datës 29.11.2023, ka lejuar përmbaremoren, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga fatura t'i paguaj shumën 4707€.

Kundër urdhrin përmbaremore debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka kundërshtuar Urdhrin për përmbaremore. Kreditori me përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin dhe ka kërkuar nga gjykata që të refuzoj prapësimin e debitorit.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles së parë-Departamenti Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbaremoret, të Përmbaremoret Privat, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se përmbaremoren është lejuar në baze të dokumentit të besueshëm, faturën të cilat janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit dhe rrjedhimisht të njëjtat paraqesin baze për lejimin e përmbaremoret në kuptim nga neni 29 LPP. Andaj marrë parasysh këto gjykata e shkallës së parë ka vendosë si në dispozitiv të aktvendimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbaremore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbaremoret privat, me të cilin është caktuar përmbaremoren i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbaremoren është lejuar në bazë të faturave origjinale të lëshuara nga kreditori, të cilat fatura në mbështetje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe të njëjtat si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbaremoret, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbaremoren i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbaremoren paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit të bashkëngjitet dokumenti i origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”* çka edhe gjykata shkallës së dytë vlerëson se kreditori ka vepruar në pajtim me këtë nen, nga të cilat fatura të besueshme është caktuar përmbaremoren.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke

vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Po ashtu vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm-faturën, të cilat kreditori ia ka bashkangjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarimit të propozuar nga kreditori, ngase faturat e lartcekura, në bazë të së cilave është caktuar përmbarimi, ligjërisht paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbarimit sepse të njëjtat janë pranuar dhe vulosur nga debitori, prandaj gjykatë vlerëson se debitori në rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht të vlefshme në mbështetje të pretendimeve të tij konform nenit 69 par.5 të LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 të LPP, prandaj vendosi që këto pretendime të refuzoj si të pabazuara.

Ndërsa lidhur me pretendimet e debitorit në ankese se fatura nuk është paraqitur si dokument përmbarues nuk është paraqitur në origjinal, gjykata vlerëson se nuk ekzistojnë këto pretendime për arsye se, në bazë të shkresave të lëndës faturat nr. nr. 18/23 dt.18.04.2023 dhe 29/2023 është në origjinal dhe përmban të gjitha elementet e kërkuara të cilat janë parapare me nenin 29 të LPP. Andaj, në bazë të dispozitave ligjore të lartcekur dhe shkresave të lëndës rezulton se urdhërim përmbarimor i plotëson kushtet ligjor të LPP. Ndërsa lidhur me pretendimin tjerë gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit rezulton të jenë të pabazuara dhe të paargumentuara ashtu që si të tilla mbesin vetëm në natyrën deklarative dhe jo relevante për të vendosur ndryshe, nga del se nuk plotësohen as kushtet ligjore nga neni 71 i LPP.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1128/24, me datë 17.07.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi